  - C) Humbje progressive neuronale në korteksin e lobeve frontale e parietale
  - D) Humbje progressive neuronale në korteksin e lobeve oksipitale e parietale
37. Skleroza laterale amiotrofike (SLA) karakterizohet nga:
- A) Humbje progressive neuronale në korteksin frontal
  - B) Humbje neuronale në traktin pyramidal
  - C) Humbje neuronale në fashikujt posterior
  - D) Humbje neuronale në cornu anterior të medullës spinale
38. Atrofitë spinocerebellare janë:
- A) Patologji demielinizante
  - B) Patologji metabolike
  - C) Patologji hereditare
  - D) Patologji vaskulare
39. Patologjitë metabolike të trashëguara të sistemit nervor shkaktohen nga:
- A) Defekte të një gjeni që kodon për një enzimë apo proteinë të rëndësishme
  - B) Defekte të kontraksionit muskular
  - C) Defekte të funksionit të harkut reflektor
  - D) Defekte të funksionit të pllakës neuro-muskulare

40. Morbus Willson është pasojë e:
- A) Anomalisë së një proteine transportuese të hekurit në organizëm
  - B) Anomalisë së një proteine transportuese të klorit në organizëm
  - C) Anomalisë së një protein transportuese të azotit në organizëm
  - D) Anomalisë së një proteine transportuese të bakrit në organizëm
41. MMSE është test i cili përdoret:
- A) Për të vlerësuar forcën muskulare
  - B) Për të vlerësuar funksionet e larta konjitive
  - C) Për të vlerësuar sensibilitetin
  - D) Për të vlerësuar ekuilibrin
42. Prova Romberg përdoret:
- A) Për vlerësimin e ekuilibrit
  - B) Për vlerësimin e memories
  - C) Për vlerësimin e sensibilitetit
  - D) Për vlerësimin e të folurit
43. Dëmtimet e motoneuroneve inferior shkaktojnë:
- A) Reflekse të pandryshuara
  - B) Hiperrefleksi
  - C) Hyporefleksi
  - D) Arefleksi
44. Dëmtimet e motoneuroneve superiore shkaktojnë:
- A) Reflekse të pandryshuara
  - B) Hiperrefleksi
  - C) Hyporefleksi
  - D) Arefleksi
45. Zona motore primare ndodhet në:
- A) Korteksin motor
  - B) Korteksin parietal
  - C) Korteksin oksipital
  - D) Korteksin temporal
46. Dhimbja neuropatike është dhimbje që shkaktohet nga:
- A) Leziona të korteksit cerebral
  - B) Leziona të radikseve nervore
  - C) Leziona muskulare
  - D) Leziona të fibrave nervore
47. Për të ekzaminuar sensibilitetin termik përdoren:
- A) Një epruvetë qelqi me ujë të ngrohtë
  - B) Një epruvetë qelqi me ujë të ftohtë
  - C) Dy epruveta qelqi njëra me ujë të ngrohtë dhe tjetra me ujë të ftohtë
  - D) Një age sterile

48. Zona sensore primare ndodhet në:

- A) Korteksin frontal
- B) Korteksin parietal
- C) Korteksin oksipital
- D) Korteksin temporal

49. Në sindromën hipotalamike (dëmtime të hipotalamusit) kemi:

- A) Hypoestezi dhe disestezi
- B) Hiperestezi
- C) Hypoestezi
- D) Anestezi

50. Halucinacionet olfaktore kanë të bëjnë me:

- A) Mungesën e nuhatjes
- B) Ekzagjerimin e nuhatjes
- C) Mungesën e shijes
- D) Perceptimin e aromave inekzistente

51. Ataksia statike është:

- A) Paaftësia për të ruajtur ekuilibrin në pozicionin në këmbë
- B) Paaftësia për të ruajtur ekuilibrin në ecje me sytë hapur
- C) Paaftësia për të ruajtur ekuilibrin në ecje me sytë mbyllur
- D) Paaftësia për të kryer provën index-nasi

52. Dismetria është:

- A) Paaftësia për ruajtjen e ekuilibrit në ecje
- B) Paaftësia për të arritur në mënyrë korrekte një shenjë
- C) Paaftësia për të kapur një objekt
- D) Paaftësia për të ecur me sytë mbyllur

53. Agnozia është:

- A) Çrregullim i kuptimit të të folurës
- B) Çrregullim i orientimit në kohë dhe hapësirë
- C) Çrregullim i njohjes së objekteve në prani të sistemeve sensoriale intakte
- D) Çrregullim i sensibilitetit taktil

54. Elektroneurografia përcakton:

- A) Aktivitetin elektrik kortikal
- B) Vijueshmërinë funksionale të harqeve reflektore
- C) Funksionin e fibrave muskulare
- D) Shpejtësinë e konduksionit nervor motor apo sensitiv

55. Epilepsia reflektore përbëhet nga atake epileptike që:

- A) Shpërthejnë pas një stimuli të caktuar
- B) Janë të palidhura me stimuj të ndryshëm
- C) Hasen më tepër në të rriturit
- D) Janë me bazë gjenetike

56. EEG bën regjistrimin e:
- A)Funksionit të harqeve reflektore
  - B)Aktivitetit elektrik kortikal
  - C)Funksionit të fibrave muskulare
  - D)Funksionit të fibrave nervore
57. Aura e migrenës është:
- A)Faza e dhimbjes maksimale të kokës
  - B)Periudha pas qetësimit të kësaj dhimbjeje
  - C)Simptomatologjia specifike që shfaqet para dhimbjes
  - D)Nuk ka lidhje me dhimbjen e kokës
58. Triada që karakterizon sëmundjen e Parkinsonit është:
- A)Hiperkinezi, parestezi, tremor
  - B)Hiperkinezi, asteni, tremor
  - C)Hypokinezi, rigiditet, tremor
  - D)Hypokinezi,asteni, tremor
59. Shkalla e Glasgow përdoret:
- A)Për të vlerësuar gjendjen e neonatin pas lindjes
  - B)Gjendjen e ndërgjegjes
  - C)Për të vlerësuar risqet e hipertensionit
  - D)Për të vlerësuar reklekset e thella
60. Pacienti me afazi të tipit Wernicke:
- A)Është në gjendje të dëgjojë të kuptojë por nuk flet dot
  - B)Nuk është në gjendje as të dëgjoje as të kuptojë
  - C)Flet rrjedhshëm por biseda e tij është pa sens llogjik
  - D)Flet rrjedhshëm por nuk dëgjon
61. Në hemiplegjinë tek i rrituri kemi:
- A)Dëmtim të palcës së kurrizit
  - B)Dëmtim të motoneuronit të parë
  - C)Dëmtim të motoneuronit të dytë
  - D)Dëmtim të sistemit ekstapiramidal
62. Në faktorët e riskut për insult cerebral futen:
- A)Hipertensioni duhani alkooli
  - B)Alkooli duhani avitaminozat
  - C)Duhani aspirina hipertensioni
  - D)Alkooli heparina duhani
63. Neuropatia periferike nuk mund të shkaktohet nga:
- A)Diabeti
  - B)Avitaminozat
  - C)Alkooli
  - D)Hypotensioni

64. Çrregullimet e ekuilibrit nuk varen nga:
- A) Patologji të veshit të brendshëm
  - B) Artroza cervikale
  - C) Patologjitë e cerebelumit
  - D) Distrofia muskulare
65. Nistagmushi është një shenjë klinike që i referohet:
- A) Aparatit lokomotor
  - B) Aparatit digjent
  - C) Aparatit viziv
  - D) Aparatit ekskretor
66. Paraplegjia intereson:
- A) Gjysmën e majtë të trupi
  - B) Gjysmën e djathtë të trupit
  - C) Një nga gjymtyrët e poshtëm
  - D) Gjysmën inferiore të trupi
67. Ataksia është:
- A) Çrregullim ekuilibri
  - B) Sinomin i afazisë
  - C) Çrregullim i të folurit
  - D) Çrregullim i tonusit muskular

## 8. Teknikat e Rehabilitimit

1. Terapia me rreze ultraviolette përdoret në pacientët me:
- A) Tendinit të muskulit biceps në fazën acute
  - B) Në traumat e freskëta
  - C) Në limfedemat e komplikuara
  - D) Në patologjitë degjenerative në fazën kronike
2. Pas një aksidenti në shtëpi një fëmijë ka pësuar një traumë koduzive në rregonin gluteal. Cfarë modaliteti duhet të përdoret menjëherë pas traumës:
- A) Termoterapi endogjene
  - B) Terapi me ultratinguj
  - C) Krioterapi
  - D) Markoniterapi
3. Cila frekuencë e ultratingujve është më penetruese në inde:
- A) 1 MHz
  - B) 2 MHz
  - C) 3 MHz
  - D) 4 MHz
4. Manjeto terapia është:
- A) Elektroterapi e kombinuar
  - B) Elektroterapi direkte
  - C) Elektroterapi indirekte
  - D) Elektroterapi me fushë të gjerë

5. Terapi me mikrovalë quhet ndryshe:

- A) Markoniterapi
- B) Terapi në furrë të nxehtë
- C) Tekarterapi
- D) Radarterapi

6. Modalitetet e terapisë fizike:

- A) Janë pjesë e kineziterapisë
- B) Janë pjesë e hidrokineziterapisë
- C) Janë terapi hyrëse në rehabilitim
- D) Janë terapi zëvendësuese të kineziterapisë

7. Elektrostimulime është terapi fizike që përdoret për të stimuluar:

- A) Muskulin e inervuar dhe nervat periferike
- B) Muskulin e denervuar dhe nervat periferike
- C) Muskulin e inervuar dhe muskulin e denervuar
- D) Nervat periferike dhe palcën e kurrizit

8. T.E.N.S është terapi antalgjike që e ul dhimbjen nëpërmjet:

- A) Stimulimit të prodhimit të dopaminës
- B) Nëpërmjet sistemit të kontrollit të portës në palcën e kurrizit
- C) Nëpërmjet bllokimit të impulseve në fibrat nervore me kalibër të madh
- D) Nëpërmjet shtimit të impulseve në fibrat nervore me kalibër të vogël

9. T.E.N.S është terapi antalgjike që gjen përdorim:

- A) Vetëm në fazën akute të shërimit të indeve
- B) Vetëm në fazën subakute të shërimit të indeve
- C) Vetëm në fazën kronike të shërimit të indeve
- D) Në të tre fazat e shërimit të indeve

10. Sipas parimit të Arkimedit, trupi i zhytur në një teren ujor:

- A) Peshon më shumë
- B) Peshon më pak
- C) Nuk i ndryshon pesha
- D) Pëson deformime të formës

11. Në tentinitin e kalcifikuar modaliteti i terapisë fizike me efikas është:

- A) Krioterapia
- B) Ultratingujt
- C) Lazerterapia
- D) T.E.N.S

12. Presoterapia është terapi:

- A) Kundër dhimbjes
- B) Kundër limfedemës
- C) Kundër kalcifikimeve
- D) Kundër hemoragjisë

13. Hidrokinezi terapia gjen kundërindikacion absolute në:

- A) Hemiplegji
- B) Paraplegji
- C) Spondiloartrozë
- D) Në dermatitin purulent

14. Thellësia e penetrimit të termoterapiës me kontakt direkt është:

- A) 1cm
- B) 3cm
- C) 5cm
- D) 10cm

15. Përpara fillimit të seancës së rehabilitimit me një pacient me hemiplegji rekomandohet:

- A) Banjë me ujë të ngrohtë
- B) Banjë me parafinë
- C) Banjë me ujë të ftohtë
- D) Banjë me hidromasazh

16. Terapia me rreze ultraviolete indikohet në:

- A) Pelagra
- B) Lupusin eritematoz
- C) Sarkoidozë
- D) Akne

17. Terapia me rreze ultraviolete kundërindikohet në:

- A) Mungesën e vitaminës D
- B) Sinuzit
- C) Psoriazis
- D) Hipertiroidizëm

18. Doza eritematoze minimale mat:

- A) Nxirjen e lëkurës
- B) Sensibilitetin e lëkurës
- C) Nivelin e djegies së lëkurës
- D) Thellësinë e penetrimit të rrezeve ultraviolete

19. Ultratingujt në rehabilitim përveç efektit antalgjik i përdorim dhe për efektin:

- A) Nxirës të lëkurës
- B) Termik
- C) Masazhues
- D) Stimulim të nervave

20. Akulli në qoftë se vendoset direkt në lëkurë jep:

- A) Vazodilatacion
- B) Rritje të permeabilitetit kapilar
- C) Zbehje të lëkurës
- D) Djegie

21. Modaliteti më efikas i përdorimit të lazerit në fizioterapi është:
- A) Me kontakt direkt me lëkurën
  - B) 20cm larg trupit
  - C) 50cm larg trupit
  - D) Me oshilim
22. Në shtatëzani mund të përdoren vetëm këto modalitete:
- A) Laser dhe jonoforezë
  - B) TENS dhe presoterapi
  - C) Manjetoterapi dhe mikrovalë
  - D) Diatermi dhe lazer
23. Terapia me ultratinguj gjen indikacion në:
- A) Tumore
  - B) Osteoporozë
  - C) Limfedemën me fibrozë
  - D) Në bursit të kalcifikuar
24. T.E.N.S është shkurtimi i fjalës:
- A) Stimuli nervor elektrik transkutan
  - B) Stimuli nervor elektrik me energji
  - C) Terapi e nervave sipërfaqësor
  - D) Terapi e nën sipërfaqshme
25. Llambat me rreze ultraviolet bëjnë pjesë në:
- A) Termo terapinë me kunduksion
  - B) Termoterapinë me konveksion
  - C) Termoterapinë me skanim
  - D) Termoterapinë me rrezatim
26. Banjot kontraste gjejnë indikacion:
- A) Në distrofinë muskulare
  - B) Në infarkt të miokardit
  - C) Në vaskulopatitë periferike
  - D) Artritin rheumatoid
27. Jonoforeza është modalitet terapeutik që realizon:
- A) Përshpejtimin e medikamenteve më anë të fushës manjetike
  - B) Përshpejtimin e medikamenteve më anë të rrymës elektrike të alternative
  - C) Përshpejtimin e medikamenteve më anë të vibrimeve akustike
  - D) Përshpejtimin e medikamenteve më anë të rrymës elektrike të vazhduar
28. Lazerterapi nuk gjen kundëridikacion absolute në:
- A) Në tre muajt e parë të shtatzanisë
  - B) Në karcinomën mamare
  - C) Në zonën hemoragjike
  - D) Në plagët e shtratit

29. Tufa e rrezeve lazer ka këto karakteristika:

- A) Një ngjyrëshe, paralele, koherente
- B) Një ngjyrëshe, paralele, jokohërente
- C) Shumë ngjyrëshe, paralele, koherente
- D) Shumë ngjyrëshe, paralele, jokohërente

30. Drita Lazer nuk përdoret në:

- A) Kirurgji
- B) Dermatologji
- C) Fizioterapi
- D) Gjinekologji

31. Aparatet e lazerterapisë që përdoren në rehabilitim përdorin si mjet aktiv:

- A) Argonin
- B) Dioksid karbonin
- C) Kryptonin
- D) Rubinin

32. Ultratingujt janë vibrime akustike të pa perceptueshme nga veshi i njeriut me frekuencë:

- A) Nën 16.000 Hz
- B) Mbi 16.000 Hz
- C) Nën 26.000 Hz
- D) Mbi 26.000 Hz

33. Efektet e terapisë me ultratinguj në rehabilitim mund t'i përmbledhin në:

- A) Mekanik, Infiamator, Termik, Kavitar
- B) Termik, Kavitar, Shkrirës, Antiedematoz
- C) Mekanik, Termik, Kimik, Kavitar
- D) Antiedematoz, Kimik, Termik, Mekanik

34. Modaliteti më i përdorur dhe efikas i terapiës me ultratinguj është:

- A) Me kontakt direkt
- B) Me lëvizje rrotulluese të kokës
- C) Me lëvizje perpendikulare
- D) Me lëvizje gjatësore të kokës

35. Terapia me ultratinguj kundërrindikohet në:

- A) Çrregullime të sensibilitetit
- B) Kalcifikime
- C) Tendinite
- D) Borsite

36. Sonoforeza është:

- A) Terapi përshpejtimi medikamentesh me anë të rrymës elektrike
- B) Terapi përshpejtimi medikamentesh me anë të mikrovalëve
- C) Terapi përshpejtimi medikamentesh me anë të ultratingujve
- D) Terapi përshpejtimi medikamentesh me anë të lazerit

37. Inflamacioni karakterizohet nga këto shenja:

- A) Dolor, Kalor, Tumor, Rubor, Funksioneza
- B) Dolor, Rubor, Kalor, Tumor, Nekroza
- C) Kalor, Tumor, Dolor, Hiperplazia, Nekroza
- D) Hiperplazia, Nekroza, Dolor, Funksioneza

38. Terapia antalgjike me korente interferenciale gjen indikacion të gjerë:

- A) Në dhimbjen sipërfaqësore
- B) Në dhimbjen e fantazëm
- C) Në dhimbjen e thellë
- D) Në dhimbjen e mprehtë

39. Në dhimbjen e artikulacionit tempo-mandibular modalitetet terapeutike që përdoren janë:

- A) Mikrovalët, Lazeri, Ultratingujt
- B) T.E.N.S, Radarterapi, Korente interferenciale
- C) Presoterapi, Radarterapi, Korente interferenciale
- D) Ultratingujt, T.E.N.S, Lazer

40. Trigger point:

- A) Janë pika të padhimbshme të trupit
- B) Janë pika të agopunturës
- C) Janë pika shumë të dhimbshme
- D) Janë pika ku vendosen elektrodat e T.E.N.S

41. Rrymat diadinamike janë:

- A) Rryma galvanike
- B) Rryma alternative retangolare
- C) Rryma sinusoidale me frekuencë të ulët
- D) Rryma të kombinuara

42. Efektet fiziologjike të rrymave diadinamike nuk lidhen me:

- A) Shtimin e vazokonstriksionit
- B) Shtimin e vazodilatacionit
- C) Rritjen e permeabilitetit të membranës qelizore
- D) Rritjen e ngacmueshmërisë së fibrave nervore me kalibër të madh

43. Rrymat diadinamike nuk kundërrindikohen:

- A) Në hemoragji
- B) Frakturat e pakonsoliduara
- C) Shtatëzani
- D) Gonartrozë

44. Reobaza është:

- A) Zona e muskulit ku intensiteti është maksimal
- B) Intensiteti minimal i impulsit i aftë të shkaktoj kontraktim muskular
- C) Intensiteti maksimal i impulsit i aftë të shkaktoj kontraktim muskular
- D) Pjesë e placës neuromotore

45. Elektrodat më komode në përdorim gjatë elektroterapisë janë:

- A) Plastike
- B) Metalike
- C) Sfungjerore
- D) Autoaderente

46. Manjeto terapia indikohet:

- A) Osteoporozë
- B) Hemiplegji
- C) Paraplegji
- D) Hypotonic

47. Llampat ultraviolet nuk japin:

- A) Djersitje
- B) Vazodilatacion
- C) Vazokuksion
- D) Të gjitha

## 9. Farmakologji

1. Adrenomimetiket shkaktojnë:

- A) Miozë
- B) Ngushtim të bronkeve
- C) Rritje të lëvizshmerisë së zorrëve
- D) Nxitje të sistemit nervor qëndror

2. Adrenomimetiket nuk duhen dhënë në të sëmurët:

- A) Astmatike
- B) Bradikardike
- C) Me arrest kardiak
- D) Hipertonike

3. Adrenalina nuk duhet kombinuar me:

- A) Betablokuesit
- B) Analgeziket opioide
- C) Benzodiazepinat
- D) Barbituratet

4. Alfa-adrenoblokuesit përdoren për mjekimin e:

- A) Hipotensionit
- B) Takikardise
- C) Isuficiences kardiake
- D) Depresionit

5. Efekti anësor kryesor i alfa-adrenoblokuesve është:

- A) Hypotensioni i theksuar postural
- B) Retensioni urinar
- C) Diareja
- D) Dhimbje artikulare

6. Beta-blokuessit përdoren për mjekimin e:

- A) Podagres
- B) Diabetit
- C) Takiaritmive
- D) Bronkitit kronik

7. Beta-blokuessit kundërrindikohen në:

- A) Insuficiencën kardiakë
- B) Hypertension
- C) Takikardi
- D) Në sëmundjen migrenoze

8. Kolinomimetikët shkaktojnë:

- A) Midriazë
- B) Ulin djersitjen
- C) Bradikardi
- D) Bronkodilatacion

9. Kolinomimetikët përdoren për mjekimin e:

- A) Glaukomës
- B) Astmës bronkiale
- C) Bradikardive
- D) Diareve acute

10. Kolinomimetiket kundërrindikohen në:

- A) Bradikardi
- B) Retensionin urinar
- C) Hipertireoze
- D) Artritin rheumatoid

11. M-kolinoblokuessit shkaktojnë:

- A) Miozë
- B) Shtim të sekrecioneve bronkiale
- C) Bronkodilatacion
- D) Bradikardi

12. M-kolinoblokuessit përdoren për mjekimin e:

- A) Kolikës renale
- B) Glaukomës
- C) Hipertrofisë së prostatës
- D) Hipertermisë

13. M-kolinoblokuessit kundërrindikohen në:

- A) Ulcerën peptike
- B) Parkinson
- C) Bradikardi
- D) Atonitë intestinale

14. Efekti anësor kryesor që vihet re gjatë përdorimit të miorelaksanteve është:

- A) Apnea
- B) Hipertensioni
- C) Hipernatremia
- D) Hipotermia

15. Morfina shkakton:

- A) Midriaze
- B) Frenim të qendrës së frymëmarrjes
- C) Shton oreksin
- D) Diare

16. Aspirina përdoret për mjekimin e:

- A) Ethes reumatizmale
- B) Për uljen e temperaturës në moshat pediatrike
- C) Insuficiencës renale
- D) Parkinsonit

17. Aspirina kunderindikohet në:

- A) Hipertension
- B) Uljen e temperaturës
- C) Dhimbjet e kokës
- D) Ulceren gastro-duodenale

18. Bari i zgjedhur për mjekimin e atakut gutoz është:

- A) Allopurinoli
- B) Probenicidi
- C) Sulfipirazoni
- D) Kolkicina

19. Cili nga këto barna anestezik jep rritje të tensionit arterial:

- A) Tiopentali
- B) Midazolami
- C) Ketamina
- D) Fentanyli

20. Benzodiazepinat shfaqin efekt:

- A) Eksitues
- B) Hipertensiv
- C) Myorelaksant
- D) Anksioz

21. Barbituratet kundëringikohen në:

- A) Epilepsi
- B) Porfiri
- C) Hypertension
- D) Takikardi

22. Bari i zgjedhur për mjekimin e statusit epileptik është:
- A) Acidi Valproik
  - B) Karbamazepina
  - C) Diazepami
  - D) Trimetadioni
23. Antipsikotikët kundërindikohen në:
- A) Parkinson
  - B) Alzheimer
  - C) Skizofreni
  - D) Në pacientët me të vjella
24. Kripërat e litiumit përdoren për mjekimin e:
- A) Epilepsisë
  - B) Parkinsonit
  - C) Gjendjes maniakale
  - D) Miastenisë grave
25. Kofeina përdoret për mjekimin e:
- A) Insuficiences acute cirkulatore
  - B) Hipertensionit
  - C) Takikardisë
  - D) Hipertireoze
26. Glukozidet kardiake përdoren për mjekimin e:
- A) Hipertensionit
  - B) Insuficiences kardiake
  - C) Fibrilacionit ventricular
  - D) Perikarditit adeziv
27. Glukozidet kardiake kunderindikohen në:
- A) Flaterin atrial
  - B) Fibrilacionin atrial
  - C) Infarktën e miokardit
  - D) Takikardinë paroksizmale supraventrikulare
28. Kinidina përdoret për mjekimin e:
- A) Aritmive atriale
  - B) Astmës bronkiale
  - C) Parkinsonit
  - D) Epilepsisë
29. Bari që preferohet në aritmitë e shkaktuara nga helmimi me digitalikë është:
- A) Verapamili
  - B) Amidaroni
  - C) Difenidani
  - D) Lidokaina

30. Bari që preferohet në mjekimin e krizës anginoze është:
- A) Propanololi
  - B) Kinidina
  - C) Digoksina
  - D) Trinitrina
31. Cili nga barnat kalciblokues mund të përdoret edhe si antiaritmik:
- A) Nifedipina
  - B) Verapamili
  - C) Amlodipina
  - D) Nikardipina
32. A është e vërtetë se diuretikët osmotikë përdoren për mjekimin e:
- A) Hipertensionit
  - B) Edemave cerebrale
  - C) Sindromit nefrotik
  - D) Asnjëra
33. A është e vërtetë se diuretikët tiazidike kundërindikohen në:
- A) Hipertoni
  - B) Insuficiencën renale
  - C) Edemën kardiake
  - D) Edemën hepatike
34. A është e vërtetë se A.C.E inhibitorët kundërindikohen në :
- A) Hipertension
  - B) Diabet
  - C) Hiperkalemi
  - D) Insuficiencë kardiake
35. A është e vërtetë se tabletat janë:
- A) Ekstrakte alkalike
  - B) Pluhura të komprimuara në makineri të posaçme
  - C) Forma farmaceutike të buta që përdoren për lyerjen e lëkurës
  - D) Tretësira ujore që përdoren me anë të aparateve të posaçme
36. Rruga natyrale e marrjes së barit është:
- A) Subkutane
  - B) Intramuskulare
  - C) Intravenoze
  - D) Inhalatore
37. Gjatë administrimit të barit me rrugë intravenoze:
- A) Efekti i barit është i ngadaltë
  - B) Efekti i barit është i kontrollueshëm
  - C) Nuk mund të japim sasi të madhe bari
  - D) Reaksionët anafilaktike janë me të lehta

38. Gjatë administrimit të barit me rrugë intramuskulare vendi më i shpeshtë i aplikimit të injeksionit në femijët e vegjël është muskuli:

- A) Deltoid
- B) Ventrogluteal
- C) Dorsogluteal
- D) Vastus Lateralis

39. Potencimi realizohet midis dy barnave:

- A) Që kanë veprim në të njëjtin drejtim
- B) Me efekte kualitativisht të ndryshme
- C) Që kanë efekte të kundërta
- D) Të gjitha
- E) Asnjëra

40. Takifilaksia është :

- A) Intolerancë e lindur e organizmit ndaj një bari të caktuar
- B) Fenomeni i mbarimit të shpejtë të efektit të një bari ndonëse administrimi i tij vazhdon
- C) Formë e veçantë e ambientimit
- D) Ndjeshmeria e rritur e fituar e organizmit nga marrja e përsëritur e barnave

## 10. Anatomi Normale

1. Brinjët e lira janë:

- A) I - II
- B) VII - VIII
- C) XI - XII
- D) VIII - IX

2. Fossa glenoidale ndodhet në:

- A) Brinjë
- B) Sternum
- C) Os.iliace
- D) Scapul

3. Është pjesë e scapulës:

- A) Procesi zigomatik
- B) Procesi stiloid
- C) Procesi coracoid
- D) Procesi acromial

4. Te cilat kocka dallojmë: Diafizën, Epifizën proximale dhe distale:

- A) Kockat e përziera
- B) Kockat spongioze
- C) Kockat sesamoide
- D) Kockat e shkurtra

5. Atlasi nuk ka:

- A) Trup
- B) Dy harqe
- C) Fovea dentis
- D) Tuberculum anterior

6. Facia aurikulare është pjesë e :

- A) Os. Costae
- B) Os. Mandibule
- C) Os. Clavicule
- D) Os. Sakrum

7. Fovea capitis ndodhet në :

- A) Os. Iliake
- B) Os. Mandibule
- C) Caput femuri
- D) Os. Sternum

8. Artikulacioni atlanto-oxipital është i tipit:

- A) Trochlear
- B) Cilindrik
- C) Elipsoid
- D) Selar
- E) Sferik

9. Artikulacioni costo-vertebral realizohet midis:

- A) Brinjës me acromion
- B) Scapula me proces coracoid
- C) Procesit transeversal të vertebrave me tuberkulave costale
- D) Capitis costae me fovea costalis të trupit të vertebrave

10. Art. karmo- metacarpal bën këto lëvizje :

- A) Flexion-Extension
- B) Pronacio-Supinacio
- C) Rrëshqitëse
- D) Rotatore
- E) Abduxio-Adduxio

11. Në M. suprahiod futen :

- A) M. Platyzma
- B) M. Digastricus
- C) M. Scalen
- D) M. Sternotiroid

12. Janë muskuj të shpinës, me përjashtim të:

- A) M. Trapezius
- B) Latisimus Dorsi
- C) M. Romboid
- D) M. Levator- Scapule
- E) M. Deltoid

13. Janë muskuj të supit, me përjashtim të:

- A) M. Deltoideus
- B) M. Supraspinatus
- C) M. Infraspinatus
- D) M. Teres minor
- E) M. Latisimus dorsi

14. Janë muskuj të përparmë të kofshës:

- A) M. Biceps Femori
- B) M. Semitendinos
- C) M. Quadriceps
- D) M. Semimembranoz
- E) M. Popliteus

15. Janë muskujt medial të kofshës me përjashtim të:

- A) M. Sartorius
- B) M. Pektineus
- C) M. Adductor- Brevis
- D) M. Adduktor Magnus+Longus
- E) M. Gracilis

16. Muskujt e përparmë të kërcirit janë:

- A) M. Gastroknemius
- B) M. Soleus
- C) M. Plantar
- D) M. Tibial anterior

17. Muskujt e pasëm të kërcirit bëjnë:

- A) Flexion të artikulacion të gjurit
- B) Extension të artikulacion të gjurit
- C) Abduktion të artikulacion të gjurit
- D) Flexion plantar të artikulacion talo-krural

18. Muskuli deltoid kryen këto funksione kur kontrahet të tre degët e tij:

- A) Rotacion të krahut
- B) Flexion të krahut
- C) Ngrerë krahun horizontalisht-abduktion
- D) Extension të krahut

19. Artikulacioni C/F realizon këto lëvizje me përjashtim të:

- A) Flexion
- B) Cirkumduktion
- C) Extension
- D) Adduktion

20. Artikulacioni S/H është artikulacion i tipit :

- A) Elipsoid
- B) Trochlear
- C) Sferik
- D) Enartrozis
- E) Cilindrik

21. Flexionin e artikulacionit të gjurit e realizojnë muskujt:

- A) Muskujt e përparmë të kofshës
- B) Muskujt e pasëm të kofshës
- C) Muskujt e pasëm të kërcirit
- D) Muskujt medial të kofshës

22. Quhen muskuj të antigravitetit të cilët e marrin funksionin pas vitit të parë të jetës:
- A) M e abdomenit
  - B) M e përparmë të kofshës
  - C) M e pasëm të bacinit
  - D) M e lateral të kofshës
23. Janë muskuj te shpinës, përveç:
- A) M. Trapezius
  - B) M. Latisimus dorsi (m. i gjerë)
  - C) M. Pektoral
  - D) M. Levator skapule
  - E) M. Romboid
24. Nuk janë muskuj të anës së përparme të trungut (kraharorit):
- A) M. Pectoral major + minor
  - B) M. Subclavius
  - C) M. Seratus Anterior
  - D) M. Intercostal Intern+Extern
  - E) M. Subscapular
25. Diafragma është muskul që merr pjesë në:
- A) Flexion të kolonës
  - B) Extension të kolonës
  - C) Merr pjesë në frymëmarrje
  - D) Ndihmon në drejt qëndrimin e bustit
26. Muskujt anësor të barkut formojnë murin lateral abdominal, me përjashtim të:
- A) M. rectus abdominis
  - B) M. obliquus abdominis externus
  - C) M. obliquus abdominis internus
  - D) M. transversus abdominis
27. Janë koka çifte të kafkës, me përjashtim të:
- A) Os. Temporale
  - B) Os. Maxillare
  - C) Os. parietale
  - D) Os. Vomer
28. M. e qafës janë:
- A) M. Platysma
  - B) M. Supraspinata
  - C) M. Infra Spinata
  - D) M. Teres Major
  - E) M. Subscapular
29. Muskujt e përparmë të krahut quhen m. flektor dhe janë:
- A) M. Triceps brachi
  - B) M. Brachialis
  - C) M. Anconeus
  - D) M. Flexor carpi radial

30. Muskujt tibial posterior janë:

- A) M. Extensor hallucis longus
- B) M. Soleus
- C) M. Extensor digitorum longus
- D) M. Peroneus longus

31. Foosa poplitea ndodhet në:

- A) Në nivel të artikulationit S/H
- B) Në nivel të artikulationit cubiti
- C) Në nivel të artikulationit genu
- D) Në nivel të artikulationit talo krural

32. Artikulationi Cubiti realizohet midis:

- A) Trochlea humeri dhe incizura olekran e ulnës
- B) Faies kondilare të tibies dhe kondileve femorale
- C) Fossa acetabulare dhe kaput femori
- D) Fossa glenoidale dhe kaput humeri

33. Artikulationi coxo-femoral realizohet midis këtyre sipërfaqeve artikulare:

- A) Fossa glenoidale me epifizën proximale të humerusit (kaput humeri)
- B) Trochlea tali me sipërfaqen artikulare talare të tibies
- C) Fossa acetabulare me kaput femori
- D) Epifizës distale të radiusit me rreshtin proximal të karpeve

34. Artikulationi genu kryen këto lëvizje:

- A) Abduktion
- B) Adduktion
- C) Flexion
- D) Cirkumduktion

35. Artikulationi temporo-mandibular është artikulationi midis:

- A) Os oxipitale me atlasin
- B) Os frontale me os parietale
- C) Os sfenoidale me os temporale
- D) Os mandibulare (kaput) me os temporale (foosa mandibulare)

36. Kockat e kafkës janë të palëvizhme me përjashtim të:

- A) Os frontale
- B) Os mandibulare
- C) Os sfenoidale
- D) Os etmoidale

37. Gjuha është organ muskular që merr pjesë në:

- A) Përthypje
- B) Njomjen e ushqimit
- C) Tretjen e ushqimit
- D) Artikulim të fjalës

38. Area olfaktore ndodhet në:

- A) Kavitetin e gojës
- B) Kavitetin e hundës
- C) Kavitetin e barkut
- D) Në sipërfaqe të gjuhës

39. Pallatum molae ose qiellza e butë ka si funksion:

- A) Artikulimin e fjalës
- B) Përcjelljen e ushqimit
- C) Mbyll orofaringun gjatë gëlltitjes
- D) Mbyll nazofaringun gjatë gëlltitjes

40. Kordat zanore janë të vendosura në:

- A) Ezofag
- B) Faring
- C) Laring
- D) Trake

41. Nr. i unazave të trakesë është:

- A) 10-14
- B) 14-18
- C) 16-20
- D) 20-24

42. Në lobujt hepatic gjaku rrjedh:

- A) Nga hapësirat portale drejt venave centrale
- B) Nga venat centrale në hapësirën portale
- C) Qarkullon brenda hapësirës portale
- D) Qarkullon deri në venën centrale

43. Pankreasi është gjendër me sekrecion endokrin dhe exokrin dhe prodhon:

- A) Bilirubinë
- B) Insulinë
- C) Pepsinë
- D) HCL

44. Heparit vendoset në:

- A) Hypokondrin e majtë
- B) Hypokondrin e djathtë
- C) Në hemitoraxin e majtë
- D) Në hemitoraxin e djathtë

45. Në faqen inferiore të heparit del:

- A) Nervi hepatic
- B) Vena hepatica
- C) Duktusi hepatic comun
- D) Arteria hepatica

46. Duktus koledok derdh në duoden këtë lëng:
- A) Pankreatik
  - B) Biliar
  - C) Gastrik
  - D) Insulin
47. Eshtë pjesë e zorrës së hollë:
- A) Zorra sigmoide
  - B) Duodeni
  - C) Rectumi
  - D) Procesi vermiforms
48. Sfinkter oddi ndodhet në:
- A) Stomak
  - B) Mëlçi
  - C) Duoden
  - D) Ezofag
49. Pulmoni dexter ka:
- A) 1 lob
  - B) 2 lobe
  - C) 3 lobe
  - D) 4 lobe
50. Në hilusin renal:
- A) Futet nervat dhe venat renale, del a. renale dhe ureteri
  - B) Futet ureteri dhe a. renale, dalin nervat dhe a. renale
  - C) Futet v. renalis dhe ureteri, dalin nervat dhe a. renale
  - D) Futet a. renale dhe nerva , del ureteri dhe venat renale
51. Në hilusin pulmonar nuk futet:
- A) Arteria pulmonare
  - B) Venat pulmonare
  - C) Bronket pulmonare
  - D) Nervat pulmonar
52. Njësia bazë funksionale e veshkës është:
- A) Alveola
  - B) Glomeruli renal
  - C) Nefroni
  - D) Hepatociti
53. Ureterët kanë gjatësi:
- A) 15cm
  - B) 20cm
  - C) 25cm
  - D) 30cm

54. Eshtë shtresa e brendshme e mitrës:

- A) Perimetri
- B) Endometri
- C) Miometri
- D) Parametrium

55. Zemra vendoset në:

- A) Hemitoraxin e majtë në mediastinin anterior
- B) Hemitoraxin e majtë në mediastinin posterior
- C) Hemitoraxin e majtë në mediastinin medial
- D) Në hypokondrin e majtë

56. Në anën e majtë të zemrës ndodhen këta ostiome, përveç:

- A) Ostiumi aortal
- B) Ostiumi i trungut pulmonar
- C) Ostiumi i 4 venave pulmonare
- D) Ostiumi atrio ventrikular i majtë

57. Janë cipa që mbështjellin zemrën:

- A) Peritoneumi
- B) Perikardi
- C) Perimetri
- D) Mediastini

58. Përmbajnë gjak venoz të gjitha, përveç:

- A) Vena cava superior
- B) Vena cava inferior
- C) Venat pulmonare
- D) Vena hepatica

59. Aorta e merr fillimin nga:

- A) Atriumi i majtë
- B) Atriumi i djathtë
- C) Ventrikuli i majtë
- D) Ventrikuli i djathtë

60. Në vena cava superior derdhen gjakun venoz:

- A) Vena porta
- B) Venat ovariale
- C) Venat iliake
- D) Venat jugulare

61. Nga aorta torakale marrin fillimin e tyre:

- A) Arteria subklavia
- B) Arteria carotis externa
- C) Arteria oftalmika
- D) Arteria intercostale

62. Arteria brachiale është degë e:
- A) Aortës torakale
  - B) Arteries axillare
  - C) Arteries carotis interna
  - D) Aortes abdominale
63. Arteria ezofageale e merr fillimin nga:
- A) Aorta torakale
  - B) Arteria carotis externa
  - C) Arteria subklavia
  - D) Arteria carotis interna
64. Trunku coeliacus është degë e:
- A) Aortës ascedente
  - B) Aortës torakale
  - C) Aortës abdominale
  - D) Harkut të aortës
65. Arteria ilaka interna ndahet në këto degë:
- A) Arteria vezikalis superior dhe inferior
  - B) Arteria femoralis
  - C) Arteria tibialis anterior
  - D) Arteria poplitea
66. Arteria tibiale posteriore është degë e:
- A) Arteries iliake interna
  - B) Arteries iliake externa
  - C) Aortës abdominale
  - D) Arteries carotis interna
67. Vena cava inferiore e derdh gjakun venoz në:
- A) Atriumin e majtë
  - B) Atriumin e djathtë
  - C) Ventrikulin e majtë
  - D) Ventrikulin e djathtë
68. Vena që bëjmë injeksionet intra venë në fossa cubiti quhet:
- A) Vena axillare
  - B) Vena subclavia
  - C) Vena mediana cubiti
  - D) Vena basilika
69. Vena më e madhe e extremiteteve të sipërme quhet:
- A) Vena cephalika
  - B) Vena mediana
  - C) Vena basilika
  - D) Vena axillare

70. Derdhin gjakun venoz në vena cava superior:

- A) Vena iliaka externa
- B) Vena iliaka interna
- C) Vena jugulare
- D) Venat hepatica

71. Sistemi nervor qëndror përbëhet nga:

- A) Nervat spinal
- B) Nervat cranial
- C) Palca e kurrizit
- D) Cipat e trurit

72. Nervat spinal për extremitetet e sipërme dalin në nivel të:

- A) C4-Th1
- B) Th1-Th12
- C) L1-S3
- D) S4-CO1

73. Nervat spinal për extremitetet e poshtme dalin në nivel të:

- A) C4-Th1
- B) Th1-Th12
- C) L1-S3
- D) S4-CO1

74. Sa çifte nervash spinal janë:

- A) 12 çifte
- B) 24 çifte
- C) 31 çifte
- D) 34 çifte

75. Degët ngjitëse të nervave spinal janë rrugë:

- A) Motore
- B) Sensitive
- C) Motore -sensitive
- D) Asociative

76. Në truncus cerebri marrin pjesë:

- A) Medula spinale
- B) Ponsi
- C) Cerebelumi
- D) Ventrikuli i IV

77. Pons ose ura lidh midis tyre këto pjesë të trurit:

- A) Sipër pons me trurin e madh
- B) Poshtë me medulla spinale
- C) Poshtë me medulla oblongata
- D) Pas me trurin e mesëm

78. Eshtë organ i ekulibrit, ndjeshmërisë së thellë, kjo pjesë e trurit:

- A) Truri mesëm
- B) Truri fundor
- C) Medula oblongata
- D) Truri i vogël

79. Lëngu cerebro spinal qarkullon nëpër:

- A) Ventrikujt e trurit
- B) Trurin madh
- C) Trurin e vogël
- D) Medula oblongata

80. Qendra kortikale e dëgjimit ndodhet në lobin:

- A) Oxipital të truri të madh
- B) Frontal të truri të madh
- C) Temporal të truri të madh
- D) Parietal të truri të madh

81. Morbus Parkinson vjen si pasojë e dëmtimeve të:

- A) Nervave kraniale
- B) Nukleuseve bazale -motorike të trurit të madh
- C) Trurit të vogël
- D) Pars oxipitale të trurit të madh

82. Realizon këto funksione sistemi komisural i trurit të madh:

- A) Trasmeton impulsin nervor
- B) Lidh giruse brenda një hemisfere
- C) Lidh nukleuset midis pjesëve të ndryshme të trurit
- D) Lidh hemisferën e majtë me hemisferën e djathtë

83. Në afazinë motore Broca, pacienti:

- A) Nuk dëgjon
- B) Nuk kupton
- C) Nuk flet dot
- D) Nuk përgjigjet saktë

84. Në afazinë Sensore-Wernicke, pacienti:

- A) Nuk flet dot
- B) Nuk dëgjon
- C) Nuk përgjigjet për atë që pyetet
- D) Nuk artikulon dot fjalët

85. Nervat cranial janë:

- A) 10 çifte
- B) 12 çifte
- C) 14 çifte
- D) 16 çifte

86.Nervi optik është:

- A) Sensorial
- B) Motor
- C) Motor-sensitiv
- D) I përzier

87.Dëmtimi i nervit stato-akustik jep këto patologji:

- A) Verbim
- B) Humbje të nuhatjes
- C) Humbje të ekulibrit
- D) Humbje të shijes

88.Nervi olfaktor është nerv që na jep impulse për:

- A) Nuhatje
- B) Shije
- C) Shikim
- D) Presionin e gjakut

89.Dega për inervimin e muskulit sfinkter pupile është degë e nervit:

- A) Abducens
- B) Oculomotor
- C) Trochlear
- D) Hypoglossus

90.Nervi trigeminal është nerv:

- A) Sensorial
- B) Motor
- C) Motor-sensitiv
- D) I përzier

91.Janë degë të nervit trigeminal:

- A) N. Cochlear
- B) N. Vestibular
- C) N.glosofaringeal
- D) N. Maxillar

92.Nervi facial është degë e nervit:

- A) Oculomotor
- B) Stato- acustik
- C) Intermediofacial
- D) Optic

93.Nervi vag del nga kafa nëpërmjet forame jugulare së bashku me nervin:

- A) Optik
- B) Glosofaringeal
- C) Abducens
- D) Trgemini

94. Nervat spinal janë vetëm nerva:

- A) Motor
- B) Sensitiv
- C) Sensitivo-motor
- D) Asociativ

95. Plexusi i krahut formohet nga degët e përparme të nervave:

- A) C4-C7
- B) C7-TH1
- C) TH1-TH4
- D) C5-TH 1

96. Dëmtimi i kujt nervi i jep dorës pamjen e "kthetrës së maces":

- A) N. Supraclavikular
- B) N. Radial
- C) N. Ulnar
- D) N. Median

97. Dëmtimi i kujt nervi jep pamjen e "gishtave të obsetrit" ose "të marrjes leje":

- A) N. Supraclavikular
- B) N. Radial
- C) N. Ulnar
- D) N. Median

98. Nervi ischiaticus është degë e plexit:

- A) Brachial
- B) Lumbar
- C) Sacral
- D) Coccygeal

99. Nervi ischiaticus shërben për inervimin e:

- A) M. Extensiv të kërcirit
- B) M. E pasëm të kofshës
- C) Lëkurën e kofshës
- D) M. Medial të kofshës

100. Prodhon hormonin e rritjes gjendra e:

- A) Paratiroides
- B) Epifiza
- C) Hypofiza
- D) Tiroides

101. Cili hormone kontrollon % e CA në kocka:

- A) Parathormoni
- B) Kalcitonina
- C) Insulina
- D) Tiroxina

102. Morbus Basedov shfaqet kur kemi:
- A) Hiper funksion të tiroides
  - B) Hipo funksion të tiroides
  - C) Tiroidit autoimunitar
  - D) Tiroidit viral
103. Rregullon metabolozmin e K, NA në organizmin e njeriut hormoni i:
- A) Paratiroides
  - B) Tiroides
  - C) Suprarenales
  - D) Epifizës
104. Hormoni i hipofizës (neurohipofiza) ka si funksion:
- A) Rritjen e trupit
  - B) Shton diurezën
  - C) Zgjeron enët e gjakut
  - D) Ngushton enët e gjakut
105. Futet në hormonet mashkullore:
- A) Estrogjenet
  - B) Folikulostimulues
  - C) Testosteroni
  - D) Prolaktina
106. Rritja e sasisë së insulinës në gjak shkakton sëmundjen e:
- A) Gjigantizëm
  - B) Diabet mellitus
  - C) Diabet insipid
  - D) Miksedemë
107. Tetania shkaktohet nga mungesa e CA në gjak e cila vjen nga:
- A) Rritja e hormonit të tiroides
  - B) Rritja e hormonit të paratiroides
  - C) Ulja e hormonit të tiroides
  - D) Ulja e hormonit të paratiroides
108. Nanizmi vjen si pasojë e:
- A) Rritjes se hormonit të hipofizës
  - B) Rritjes se hormonit të epifizës
  - C) Uljes se hormonit të hipofizës
  - D) Uljes se hormonit të epifizës
109. Janë pjesë të veshit të brendshëm:
- A) Malleus (cekici)
  - B) Incus (kudhra)
  - C) Cochlea
  - D) Stapes (yzengjia)

110. Janë pjesë të veshit të mesëm:

- A) Kanalet semicirkulare
- B) Incus (kudhra)
- C) Cochlea
- D) Organi i Kortit

111. Janë pjesë të tunika vaskuloza (uvea) të syrit:

- A) Irisi
- B) Sklera
- C) Kornea
- D) Kristalini

112. Tunika nervoza bulbi përbëhet nga:

- A) Chorioidea
- B) Irisi
- C) Gjendrat lakrimale
- D) Retina

113. Retina përmban disa lloje qelizash që janë:

- A) 1 tip qelizash
- B) 2 tipe qelizash
- C) 3 tipe qelizash
- D) 4 tipe qelizash

## 11. Paraklinike

1. Cili nga të mëposhtmit është funksion i membranës qelizore:

- A) Inicicion transduksionin e sinjali
- B) Transporton jone dhe molekula të tjera
- C) Formon kanale selective
- D) Të gjitha

2. Qelizat shpenzojnë rreth 40% të energjisë së tyre ditore në cilin prej proceseve:

- A) Transport aktiv
- B) Endocitozë
- C) Exocytosë
- D) Difuzion të lehtësuar

3. Me cilin lloj procesi transportohet glukoza prej proteinës mbartëse nga një zonë me përqendrim më të lartë drejt një zone me përqendrim më të ulët:

- A) Transport aktiv
- B) Endocitozë
- C) Difuzion i lehtësuar
- D) Difuzion i thjeshtë

4. Pjesa e sistemit nervor që konsiderohet e pavullnetshme është:

- A) SN somatic
- B) SN autonom
- C) SN sensor
- D) SN motor

5. Invaginimet e sarkolemës që formojnë zgjatime në formë gishtërinjsh që depërtojnë në brendësi të fibrës muskulare quhen:
- A) Retikulum sarkoplazmik
  - B) Retikulum endoplazmatik
  - C) Tubujt T
  - D) Filamentet e aktines
6. Segmenti i miofibrilit i quajtur sarkomer gjendet midis:
- A) Dy linjave Z
  - B) Dy bandave A
  - C) Dy zonave H
  - D) Dy aktinave
7. Në një sinaps neuro-muskular neuroni e çliron neurotransmetuesin në:
- A) Pllakën motore
  - B) Citoplazmën e qelizës muskulare
  - C) Cisternat terminale
  - D) Hapësirën sinaptike
8. Një njësi motore përbëhet nga:
- A) Të gjitha fibrat muskulare brenda një muskuli të caktuar
  - B) Nga një neuron motor dhe fibrat muskulare që ai kontrakton
  - C) Të gjitha neuronet që inervojnë një pjesë të caktuar të trupit
  - D) Një muskul dhe një nerv
9. Janë shenja të inflamacionit përveç:
- A) Dhimbjes
  - B) Skuqjes
  - C) Temperaturës
  - D) Hypertensionit arterial
10. Cila nga molekulat e mëposhtme bën të mundur që muskuli të sigurojë energjinë e nevojshme për kontraksion duke gjeneruar ATP prej ADP:
- A) Creatinë fosfati
  - B) Fosfokinaza
  - C) Acetilkolinesteraza
  - D) Katalaza
11. Ku ndryshon fizilogjia e kontraksionit muskular midis muskulit të lëmuar dhe atij të strijuar:
- A) Muskuli i lëmuar kontraktohet më shpejt se ai i strijuar
  - B) Muskuli i strijuar përdor dy neurotransmetues ai i lëmuar vetëm një
  - C) Muskuli i lëmuar shfaq aktivitet spontan dhe mund të modifikohet nga veprimi i HO
  - D) Muskuli i lëmuar nuk përmban të njëjtët elemente tkurrës si ai i strijuar
12. Cila nga qelizat e mëposhtme prodhon antikorpe:
- A) Limfocitet T
  - B) Limfocitet B
  - C) Monocitet
  - D) Fagocitet

13. Degëzimet nervore të cilat përcjellin impulsin drejt trupit të neuronit quhen:
- A) Aksone
  - B) Dendrite
  - C) Trupa Nissl
  - D) Neurofibrile
14. Sistemi nervor autonom inervon të gjitha më poshtë përveç:
- A) Muskulit kardiak
  - B) Gjendrave egzokrine
  - C) Muskulit skeletik
  - D) Traktit tretës
15. Zgjidhni thënien e pasaktë ndër të mëposhtmet lidhur me përçimin e impulsit nevor:
- A) Përçimi i impulsit nervor bëhet sipas ligjit gjithçka ose asgjë
  - B) Një stimulim me intensitet më të lartë shkakton impulse më të fuqishme
  - C) Përçimi i impulsit në fibrat e mielinizuara bëhet me kërcim nga një nyje Ranvier në tjetrën
  - D) Arritja e potencialit të veprimit rrit përshkueshmërinë e membranës aksonale
16. Neurotransmetuesit të cilët rrisin permeabilitetin e membranës post sinaptike për jonet Na dhe potencojnë impulsin nervor quhen:
- A) Inhibitorë
  - B) Eksitues
  - C) Aktive
  - D) Neutral
17. Pjesa fillestare e harkut reflektor është:
- A) Interneuroni
  - B) Fijet efektore
  - C) Receptorët ndijësor
  - D) Neuronit motor
18. Aktiviteti elektrik i muskulit vlerësohet me:
- A) EEG
  - B) EMG
  - C) ECG
  - D) MRI
19. Cili është rajoni i retinës që përgjigjet për mprehtësinë e pamjes:
- A) Sclera
  - B) Lëngu qelqor
  - C) Fovea centralis
  - D) Disku optic
20. Shkopinjte janë qeliza fotoreceptore që përgjigjen për:
- A) Informacionin në errësirë
  - B) Ngjyrën dhe detajet e objekteve
  - C) Informacionin në dritë të bollshme
  - D) Ngjyrën dhe detajet e objekteve dhe informacionin në dritë të bollshme

21. Kontrolli i çlirimit hormonal bëhet nga organizmi me të gjitha rrugët e mëposhtme përveç:
- A) Feed-back negative
  - B) Stimulim nervor
  - C) Çlirim i HO kontrolluese
  - D) Auto destruksion i gjendrës endocrine
22. Hormonet e mëposhtme çlirohen nga antehipofiza përveç:
- A) FSH
  - B) TSH
  - C) ACTH
  - D) HAD
23. Hormoni i prodhuar në kortexin e gjendrës mbiveshkore që vepron në veshkë duke mbajtur Na e duke eliminuar K dhe që indirekt ndikon në ruajtjen e presionit arterial është:
- A) Aldosteroni
  - B) Epinefrina
  - C) Kortizoli
  - D) Adrenalina
24. Rritja e nivelit të hormoneve të tiroides në gjak jep efektet e mëposhtme përveç:
- A) Rënie në peshë
  - B) Rritje të metabolizmit bazal
  - C) Rritje të debitit kardiak
  - D) Rënie të metabolizmit të karbohidrateve
25. Cila pjesë (element) e eritrocitit mund të riciklohet në palcën e kockave për prodhimin e eritrociteve të reja:
- A) Globina
  - B) I gjithë eritrociti
  - C) Biliverdina
  - D) Hekuri
26. Cili nga përbërësit ushqimorë është më i rëndësishëm për prodhimin e eritrociteve:
- A) Ca
  - B) Na
  - C) Proteinat
  - D) Vitamina B12 dhe acid Folik
27. Zgjidhni alternativën e cila përshkruan në mënyrë të saktë fazat e hemostazës:
- A) Kogulim i gjakut formim i trombit spazmë e enës së gjakut
  - B) Formim i trombit koagulim i gjakut spazmë e enës së gjakut
  - C) Spazmë e enës së gjakut formim i tapës trombocitare formim i
  - D) Spazmë e enës së gjakut koagulim i enës së gjakut formim i trombit
28. Një person që ka bërë infarkt të muskulit të zemrës probablisht ka një bllokim të:
- A) Pulmonare
  - B) V. Cava
  - C) W. Coronare
  - D) Coronare

29. Kur mbyllen valvulat atrio ventrikulare (A-V) gjatë ciklit kardiak:
- A) Kur pace-makeri dërgon një impuls
  - B) Kur presioni brenda atriumeve është më i madh se presioni brenda ventrikujve
  - C) Kur ventrikujt kontrahohen
  - D) Kur presioni në aortë është më i madh se VM
30. Cila pjesë e zemrës funksionon si pacemaker duke dërguar impulse:
- A) Nyja Sino-Atriale
  - B) Nyja Atrio-Ventrikulare
  - C) Fijet Purkinje
  - D) Tufa e Hiss
31. Kompleksi QRS në ECG tregon:
- A) Depolarizim të atriumeve
  - B) Depolarizim të ventrikujve para kontraksionit
  - C) Repolarizim të ventrikujve
  - D) Zemra në qetësi
32. Ç'lloj imuniteti japin vaksinat:
- A) Imunitet artificial të fituar pasiv
  - B) Imunitet natyral aktiv
  - C) Imunitet natyral pasiv
  - D) Imunitet artificial të fituar aktiv
33. Cili është funksioni i mëlçisë në digjestion:
- A) Prodhon enzima digjестive
  - B) Prodhon lëndë alkaline për të neutralizuar aciditetin e stomakut
